



REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/1490/17 Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica 02 Nr. pages	Data Datum 12-06-2017 Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 1) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.06.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-215/17, për z. Izet Rushiti, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Lokale Ambienti – Ferizaj, për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, prandaj është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Izet Rushiti, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Lokale Ambienti – Ferizaj dhe njëkohësisht Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë nga raportuesi i rastit, Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar hetime administrative për gjendje të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Prandaj, zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Rushiti ka deklaruar se ka dhënë dorëheqje nga ky funksion publik Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar edhe një shkresë zyrtare nga zyrtari i lartë

(DPKI.03-02/602/17) me të cilën dëshmohet se z. Rushiti ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

